



BURSAT STUDIMORE TË NIVELIT BACHELOR NË DEGËN TEOLOGJI NDËRKOMBËTARE



PËR TË QENË SHPRESË E NJERËZIMIT



diyanetburslari.tdv.org

UDHËZUES PËR APLIKIM



TÜRKİYE
DİYANET VAKFI
TÜRKİYE DIYANET FOUNDATION
وقف الديانة التركي



DERISA MIRËSIA TË DOMINOJË NË RRUZULLIN TOKËSOR

Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë (Türkiye Diyanet Vakfı – TDV) është një institucion joqeveritar dhe jofitimprurës, i themeluar më 13 mars 1975, me qëllim që të ndihmojë dhe mbështesë Kryesinë e Çështjeve Fetare të Turqisë.

Aktivitetet dhe detyrat e tij i ushtron në shtatë kontinente, me synimin që të përçojë shërbimet dhe veprimtaritë fetare te masat e gjera, si dhe të formojë e të edukojë brezin që do të marrë përsipër detyra dhe përgjegjësi në shërbimet e veprimtaritë fetare.

PËRMBAJTJEN

AKTIVITETET ARSIMORE DHE MËSIMDHËNËSE.....	4
Përparësia jonë është arsimimi dhe edukimi	5
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	6
ARSIMI DHE EDUKIMI NË FAKULTETET E TEOLOGJISË	7
Fakultetet e Teologjisë, me të cilat realizohet bashkëpunim në kuadër të bursave studimore.....	8
Kontaktet.....	8
MUNDËSITË E OFRUARA NDAJ STUDENTËVE ME BURSË STUDIMI	9
Mundësitë studimore të ofruara në mjediset e shkollës	9
Mundësia për bursë studimi.....	9
Shëndeti.....	9
Shpenzimet për studimet.....	9
Transporti.....	10
Kampet verore dhe dimërore	10
Kurse akademike përforcuese dhe mbështetëse	10
PROBLEMET E HASURA DHE ÇËSHTJET QË DUHET TË KEMI PARASYSH.....	11
APLIKIMI DHE KUSHTET E APLIKIMIT	12
Çështje të intervistës.....	13
Qendrat e intervistave	13
REGJISTRIMI PËRFUNDIMTAR.....	14

AKTIVITETET ARSIMORE DHE MËSIMDHËNËSE

Që nga dita e themelimit, "Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare ka mishëruar trashëgiminë e qytetërimit të hershëm, ka mbartur brengën e ummetit dhe mundohet të edukojë e formojë individë me vetëbesim të plotë, si dhe specialistë në fushat përkatëse."

Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë ofron bursa studimi për studentët e suksesshëm, ka hapur konvikte për ata që ndjekin arsimin e lartë, ofron shtëpi për nxënësit e ardhur nga jashtë shtetit, zotëron kolegje dhe universitete, drejton projekte si Medreseja Ndërkombëtare, apo programe ndërkombëtare të nivelit universitar dhe pasuniversitar për teologji ndërkombëtare, duke u ofruar mundësi studimi dhe arsimit studentëve nga 111 shtete, si dhe duke ndërtuar njëkohësisht edhe ura lidhëse ndërmjet popujve.

Me mundësitë që ofron në fushën e arsimit dhe të edukimit, fondacioni ynë i vijon aktivitetet dhe veprimtaritë e tij prej një periudhe tashmë 46-vjeçare.



Përparësia jonë është arsimimi dhe edukimi

Në kuadër të veprimtarisë sonë në disa shtete të tjera, kryesisht në Azerbajxhan, Kazakistan, Kirgizistan, Rumani, Bullgari, Pakistan, Bangladesh, Haiti, Malajzi, Republika Turke e Qipros Veriore, Mongoli, Palestinë, Gjeorgji dhe Somali, 8 193 studentë nga 25 institucione arsimore-edukative vazhdojnë studimet, të mbështetur nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë. Deri më sot, nga këto shkolla janë diplomuar 9 601 studentë.

Programet e bursave studimore të Fondacionit të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë kanë një rol të rëndësishëm në kontekstin e veprimtarive të përgjithshme arsimore të fondacionit. Në këtë kuadër, ne ofrojmë mundësi arsimi për 2 595 studentë të ardhur në Turqi nga 111 shtete të ndryshme, të cilët vijojnë studimet në nivelin e medresesë, nivelin e shkollës së lartë, masterit dhe doktoratës në Fakultetet e Teologjisë.

Synimi ynë është që këtë mundësi t'ua ofrojmë shoqërive dhe popujve muslimanë, të cilët janë privuar nga mundësia e marrjes së arsimimit në përgjithësi, ndërsa në veçanti nga mundësia e marrjes së arsimit dhe edukimit në fushën fetare. Në përputhje me synimin dhe qëllimin e themelimit të këtij fondacioni, objektivi ynë është që të mbështetim arsimimin dhe edukimin fetar të shoqërive, kudo qofshin ato, si dhe të japim një kontribut në zhvillimin e këtij arsimimi.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Ofrimi nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë i bursave studimore në nivel universitar në Fakultetet e Teologjisë ka si synim pikat e mëposhtme:

- a) Të kontribuojë në nevojën arsimore të shoqërive muslimane jashtë shtetit;
- b) Të ofrojë mundësinë e arsimimit dhe edukimit ndaj studentëve të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm, të cilët perceptojnë fenë islame dhe përvojën e qytetërimit islam dhe që do të udhëzojnë shtetet e shoqërinë rreth tyre;
- c) Të ndërtojë ura kulturore lidhëse mes vendit tonë dhe shoqërive në fjalë;
- d) Të ndajë përvojat e veta në fushën e arsimit dhe të edukimit fetar.



ARSIMI DHE EDUKIMI NË FAKULTETET E TEOLOGJISË

Në thelb, fakultetet e Teologjisë formohen nga tri shkencat dhe departamente kryesore. Studentët në nivel të arsimit të lartë marrin mësim nga departamentet e mëposhtme:



Shkencat Themelore Islame: Ky departament, i cili qëndron në themel të fakulteteve të Teologjisë,

krahas informimit në lidhje me burimet bazë të fesë Islame, ka në optikën e vet edhe shkencat që qëndrojnë pas kërkimit dhe analizës së këtyre burimeve, të tilla si legjislacioni islam dhe morali. Pjesë e këtij departamenti janë edhe degë të tjera të shkencës, të tilla si Kelami (Apologjëtika islame), Tefsiri, Hadithi, Jurisprudenca islame (Fikhu), Tasavvufi (Misticizmi), Historia e medh'hebeve (Shkollave besimore-fetare) islame, Gjuha dhe letërsia arabe, Leximi i Kur'anit dhe Shkenca e Kiraatit (Shkenca e leximit të Kur'anit).

Departamenti i Filozofisë dhe Shkencave Fetare: Në krahasim me shtetet e tjera islame, njëri prej kritereve që i jep përparësi studimit në nivelin e Teologjisë në Turqi është fakti se Departamenti i Filozofisë dhe i Shkencave Fetare është integruar në arsimdhënien e Teologjisë. Disiplinat themelore që përfshihen në Departamentin e Filozofisë dhe të Shkencave Fetare janë si në vijim: arsimit dhe edukimi fetar, filozofia fetare, psikologjia fetare, sociologjia fetare, historia e feve, historia e filozofisë, filozofia islame dhe logjika.

Departamenti i Historisë dhe i Arteve Islame: Në këtë departament, i cili është pjesë e programit të fakultetit të Teologjisë, me qëllim që të plotësohet përmasa historike, artistike dhe letrare, ofrohen mësimet si Historia islame, Historia e arteve turko-islame, Letërsia turko-islame dhe Muzika fetare turke.

Kur merret parasysh pasuria dhe larmishmëria e departamenteve kryesore, një student që do të marrë arsim mbi Teologjinë në Turqi, krahas shkencave themelore islame, do të ketë mundësinë të krijojë një bazë themelore edhe në lidhje me degët kryesore, të tilla si filozofia, letërsia, historia, sociologjia, psikologjia dhe historia e arteve.

Fakultetet e Teologjisë, me të cilat realizohet bashkëpunim në kuadër të bursave studimore

Kontaktet

Universiteti Ankara, Fakulteti i Teologjisë

Bahriye Üçok Cd. 06500 Beşevler/ANKARA

Telefon: +90 312 212 68 00 Faks: +90 312 213 00 03

Web: divinity.ankara.edu.tr - e-posta: ilahiyat@ankara.edu.tr

Universiteti i Shkencave Sociale Ankara, Fakulteti i Shkencave Fetare

Hükümet Meydanı No: 2 06050 Ulus, Altındağ/ANKARA

Telefon: +90 312 596 46 13

Web: if.asbu.edu.tr – e-posta: dif@asbu.edu.tr

Universiteti Marmara, Fakulteti i Teologjisë

Mahir İz Cd. No: 2 Bağlarbaşı 34662 Üsküdar/STAMBOLL

Telefon: +90 216 777 47 00 - Faks: +90 216 777 47 00

Web: ilahiyat.marmara.edu.tr - e-posta: ilahiyat@marmara.edu.tr

Universiteti i Stambollit, Fakulteti i Teologjisë

İskenderpaşa Mh. Kavalalı Sk. No: 1 Fatih/STAMBOLL

Telefon: +90 212 440 000 – 267054 – Faks: +90 212 532 62 07

Web: ilahiyat.istanbul.edu.tr - e-posta: ilahiyat@istanbul.edu.tr

Universiteti Uludağ, Fakulteti i Teologjisë

Fethiye Mh. Kırlangıç Sk. No: 2 16140, Nilüfer/BURSA

Telefon: +90 224 243 15 70 - Faks: +90 224 243 15 73

Web: uludag.edu.tr/ilahiyat – e-posta: ilhdekanlik@uludag.edu.tr

Universiteti Necmettin Erbakan, Fakulteti i Teologjisë Ahmet Keleşoğlu

Aşkan Mh. Yeni Meram Cad. No. 136 42090 Meram/KONYA

Telefon: +90 332 323 82 50 Faks: +90 332 323 82 54

Web: erbakan.edu.tr/ilahiyat – e-posta: ilahiyat@erbakan.edu.tr

Universiteti Erciyes, Fakulteti i Teologjisë

Köşk Mh., Ahmet el Biruni Cad., 38030 Melikgazi/KAYSERİ

Telefon: +90 352 437 49 24 - Faks: +90 352 437 42 00

Web: ilahiyat.erciyes.edu.tr – e-posta: ilahiyat@erciyes.edu.tr

MUNDËSITË E OFRUARA NDAJ STUDENTËVE ME BURSË STUDIMI

Mundësitë studimore të ofruara në mjediset e shkollës

- Fusha sportive të hapura dhe të mbyllura
- Shëtitje në vende historike dhe qytete të ndryshme
- Organizim pikniku dhe aktiviteteve të tjera sociale
- Konferenca, simpoziume, panele
- Punime akademike



Mundësia për bursë studimi

Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, krahas strehimit, ushqimit dhe shpenzimeve të udhëtimit për studentët me bursë të plotë që janë pranuar në programin e bursave, ofron edhe mundësinë e bursës mujore.

Shëndeti

Siguracionet shëndetësore vjetore të përgjithshme të studentëve paguhen nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, me qëllim që nxënësit të mund të përfitojnë nga çdo lloj shërbimi shëndetësor në Turqi.

Shpenzimet për studimet

Shpenzimet vjetore të studentëve për studime paguhen nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë.

Transporti

Shpenzimet e ardhjes për herë të parë të studentëve në Turqi dhe për kthimin në fund në vendet e tyre, si dhe vajtje-ardhjet një herë në vit në shtetet e tyre paguhen nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë.

Kampet verore dhe dimërore

Programet semestrale mësimore parashikojnë organizimin e kampeve verore e dimërore, pa pagesë, me qëllim çlodhjen e studentëve nga mësimet, si dhe për përforsimin e mësimëve të arabishtes dhe të Kur'anit të Madhërueshëm. Këto kampe gjenden jashtë qytetit dhe përfshijnë aktivitete si noti, sporti dhe eksplorimi.

Kurse akademike përforsuese dhe mbështetëse

Në lëndën e arabishtes dhe në të gjitha fushat shkencore përgatiten dhe zbatohen programe mbështetëse akademike, me qëllim përkrahjen dhe realizimin e mësimëve të fakultetit nga studentët.



PROBLEMET E HASURA DHE ÇËSHTJET QË DUHET TË KEMI PARASYSH

Në fazën e aplikimit duhet të kini parasysh hapat e mëposhtëm: leximin e kujdesshëm të udhëzuesit të aplikimit, plotësimin tërësisht e në mënyrë të drejtë të formularit të aplikimit, si dhe të bëni aplikimin në kohën e duhur. Pasi të plotësoni aplikimin do t'ju dërgohet një e-mail në postën tuaj elektronike, ku do t'ju bëhet e ditur se është marrë aplikimi juaj. Pas anëtarësimit mund të hyni në sistem nëpërmjet faqes suaj personale dhe mund të kontrolloni gjendjen e aplikimit tuaj.

Plotësimi i plotë dhe i saktë i adresës dhe numrit të kontaktit është i një rëndësie të veçantë për realizimin në mënyrë të shpejtë të komunikimit. Komunikimi mes studentëve dhe Fondacionit të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë do të zhvillohet nëpërmjet adresës së e-mail-it. Për këtë arsye duhet që studentët t'i mbajnë vazhdimisht aktive adresat e tyre të e-mail-it. Aplikimet e atyre që kanë plotësuar formular në mënyrë të gabuar ose të paplotë, mund të anulohen në çdo fazë të vlerësimit.

Po ashtu, plotësoni me patjetër informacionet e referencës në formularin e aplikimit.

Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë do të pranojë çdo vit një sasi të caktuar studentësh, bazuar në kuotat e përgjithshme.



APLIKIMI DHE KUSHTET E APLIKIMIT

Për kandidatët që do të aplikojnë në programin e bursave studimore në nivel të universiteteve ndërkombëtare të ofruar nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, janë përcaktuar kushtet e mëposhtme. Aplikimi i personave që nuk i plotësojnë këto kushte, do të konsiderohet i pavlefshëm.

1. Aplikuesi nuk duhet të jetë nënshtetas i Republikës së Turqisë.
2. Nënshtetasit e Republikës së Turqisë dhe personat që e kanë humbur nënshtetësinë, për çfarëdolloj arsyeje, nuk mund të aplikojnë për bursë studimore universitare që ofrohet nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë.
3. Aplikuesi të ketë lindur pas datës 01.01.2000.
4. Të jetë i shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht, si dhe të mos ketë ndonjë pengesë tjetër për studimet në Turqi.
5. Të ketë përfunduar gjimnazin në një institucion arsimor ekuivalent me gjimnazet në shtetin tonë (në Turqi), me një notë prej më e pakta 70 për qind e vlerës së përgjithshme të notës ose të ketë mundësinë e diplomimit në muajin korrik të këtij viti.
6. Të mos ketë marrë dënim disiplinor e as dënim me burg gjatë kohës së studimit në shtetin e tij.
7. Të mos ketë kaluar një periudhë ndërprerjeje më shumë se dyvjeçare pas përfundimit të gjimnazit.
8. Aplikuesi të mos jetë përjashtuar më parë nga bursat studimore të Fondacionit të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, teksa vazhdonte të merrte arsim në cilëndo fazë studimore dhe bursë mujore nga fondacioni ynë.
9. Aplikuesi duhet që të mos jenë momentalisht në proces arsimimi në një program në Turqi, në nivelin ku edhe do të aplikojë.

Intervistat dhe vlerësimi i aplikimeve

Aplikimet tuaja do të vlerësohen nga specialistët që dërgohen në vendin tuaj. Sipas rezultatit të vlerësimit paraprak, kandidatët e konsideruar të përshtatshëm do të ftohen për intervistë. Kandidatëve të konsideruar si jo të përshtatshëm do t'u dërgohet e-mail informues. Pasi komisioni i posaçëm të bëjë vlerësimin paraprak, do të zhvillohet intervista me një delegacion që do të ngarkohet me detyrë për çështjen e intervistave dhe sipas rezultateve të intervistës do të bëhen pranimet përfundimtare. Të dhënat e kandidatëve të pranuar përfundimisht do t'u dërgohen autoriteteve të zbatimit të ligjit për hetimin e posaçëm të sigurisë. Kandidatët, rezultatet e hetimeve të të cilëve do të jenë negative, edhe sikur të pranohen, nuk sillen në Turqi. Pas kësaj etape çdonjërit prej kandidatëve do t'i bëhet e ditur data e fillimit të arsimit dhe vendi ku do të marrë mësim.

Çështje të intervistës

- Teste të aftësisë vizuale;
- Leximi i Kur'anit të Madhërueshëm dhe informacionet mbi shkencën e texhvidit;
- Të dhëna të përgjithshme fetare (besimi, adhurimi, sijeri (jeta e Pejgamberit s.a.s.), morali);
- Kulturë e përgjithshme;
- Aftësia e vetëparaqitjes;
- Vetëdija për zgjedhjen e tij;
- Aftësi të veçanta;
- Aftësia e mësimit të gjuhës.



Qendrat e intervistave

Intervistat do të organizohen në ambasadat e Republikës së Turqisë, në agjencitë për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), në institutet Yunus Emre, në shkollat e varura nga Fondacioni Maarif i Turqisë dhe në qendrat e përcaktuara nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare.

REGJISTRIMI PËRFUNDIMTAR

Forma e regjistrimit përfundimtar dhe datat përkatëse do t'u bëhen të ditura kandidatëve të pranuar pas intervistës, me anë të faqes sonë të internetit. Përveç kësaj studentëve do t'u dërgohen informacione nëpërmjet e-mail-it.

Shënime të rëndësishme në lidhje me regjistrimin përfundimtar

- a) Kandidatët duhet të aplikojnë personalisht për regjistrimin. Regjistrimi nuk mund të bëhet me anë të e-mail-it.
- b) Nuk pranohen për regjistrim kopjet e dokumenteve të pamiratuara zyrtarisht dhe as fotokopjet e tyre.
- c) Nëse dokumentet do të jenë të paplota, regjistrimi nuk kryhet.
- d) Kandidatët, të cilët nuk do të bëjnë regjistrimin brenda datave të caktuara, e humbasin të drejtën e bursës studimore.
- e) Para regjistrimit, studentët e pranuar në programin e bursave studimore do të firmosin një marrëveshje, ku shprehen se do të respektojnë kushtet e bursës, rregullat morale të përgjithshme të Turqisë dhe rregullat e disiplinës të përcaktuara nga universiteti. Në rast se nuk respektojnë këtë marrëveshje, pranojnë dhe miratojnë se do të humbasin të gjitha të drejtat.



Dokumentet e kërkuara nga studentët që fitojnë të drejtën e regjistrimit përfundimtar

1. Originali ose kopja e miratuar nga institucionet zyrtare, që tregon diplomimin e studentit në nivel të shkollës së mesme.
2. Lista e notave, e cila tregon se studenti ka përfunduar me nivel të mirë shkollën e mesme. Nëse është nxënës që po ndjek vitin e fundit, duhet të dorëzojë listën origjinale të notave të vitit të fundit, ose një fotokopje të miratuar nga institucionet zyrtare.
3. Dokumenti i njehsimit të diplomës së studentit (në turqisht).
4. Pasaporta origjinale ose fotokopje e saj e miratuar nga institucionet zyrtare.
5. Vizë legjitime studimore.
6. Raport mjekësor i marrë nga një institucion shëndetësor zyrtar, i cili tregon se studenti gëzon shëndet të plotë për studimin në Turqi.
7. Gjashtë fotografi pasaporte (në përmasat 4,5 x 6 cm).
8. Referencë në lidhje me studimin në Turqi.
9. Nëse zotëron, certifikata akademike, profesionale dhe certifikata mbi njohjen e gjuhëve të huaja.



TÜRKİYE
DİYANET VAKFI
TÜRKİYE DIYANET FOUNDATION
وقف الديانة التركي

diyanetburslari.tdv.org
egitim@tdv.org